



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:125389

Datë: 30.12.2020

Numri i dokumentit: 01382657

C.nr.526/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Florije Qerimi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H. Q nga Gjilani, me vendbanim në, kundër të paditurëve B. S nga K. Gjilanit dhe V. B R. nga Gjilani, me adresë alternative në vendin e punës në Kuvendin e Rep. së Kosovës, me objekt kontesti për kompenzim të dëmit materia dhe jo material për shkak të shpifjes dhe fyerjes, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datën 09.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses H. Q nga Gjilani mbi bazën e parashkrimit e ushtruar ndaj të paditurëve B. S nga fshati, K.Gjilanit dhe V. B, R. nga Gjilani, me të cilën paditësja ka kërkuar që t'a aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar dhe t'i detyroj të paditurit t'ia kompensojnë në emër të cenimit të dinjitetit shumë në vlerë prej 4,000,000 (katër milion) €, në emër të dhimbjeve shpirtërore, cenim të autoritetit dhe të nderit shumë në vlerë prej 4,000,000 (katër milion) € dhe në emër të shpifjes dhe fyerjes shumë në vlerë prej 2,000,000 (dy milion) €.

II.OBLIGOHET paditësja H. Qqë të paditurëve të j'a kompensojë shumë prej 845 € në emër të shpenzimeve procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësja në këtë gjykatë më dt.13.06.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurve, duke theksuar se paditësja ka shkuar në D. K. të A ..., për tu interesuar lidhur me një vend pune e që i padituri B. S ish –zyrtar i lartë në D. K të A..., brenda objektit të D. K të A..., me datën 16.03.2018, rreth orës 13:30 min.e ka fyer rënd dhe ka shpifur për paditësen duke e cënuar dhe shkelur mbi moralin e saj, ku i është drejtuar me fjalët,,kurvo hup prej këtuhi", por ky nuk ishte hera e parë me ku paditësja është fyer nga B. S e që për herë tëparë kishte ndodhur më datë 08.09.2016.

Paditësja rastin e ka paraqitur në formë të deklaratës në Stacionin Policor e që lënda është regjistruar me nr.CA ..., më tej ka theksuar se i padituri parë ka arritur të bllokoj procedurën e rregullt për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret për tu punësuar në një pozitë në arsim në mënyrë që paditëses it largojë çdo mundësi për punësim në institucionet arsimore brenda periudhës 9 vjeçare në të cilën ka aplikuar vazhdimisht (ku paditësja ka diplomuar më datë 27.02.2009 F. i E...), më tej ka theksuar se i padituri parë ka shpifur për paditësen tek shumë zyrtar të DKA-së duke thënë se ajo është „ kurvë dhe ka pasur”. dhe si prova padisëja i ka bashkëngjitur:

- Ankesën drejtuar DKA-Gjilane datës 09.09.2016;
- Vendimi i DKA-Gjilan me nr.të protok.... i datës 27.08.2016;
- Ankesën drejtuar M. A. Sh. dhe T. e datës 04.10.2016;
- Përgjigjen nga Departamenti i Inspeksionit të Arsimit në Gjilan, me nr.ref...., me nr.prot.348/16 i datës 24.10.2016;
- Ankesën drejtuar D. të D. të I.t në MASHT-Prishtinë, e datës 31.10.2016;
- Vendimin e lëshuar nga Z.e S. të P. D. i I. me nr.të ref ... nr.prot... i datës 06.12.2016;
- K. për S. e P. në MASHT-Prishtinë, e datës 19.12.2016;
- Përgjigje në kërkesën e paditëses të lëshuar nga MASHT me ref... e datës 20.03.2012;
- Konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të caktuar të shpallur nga DKA-Gjilan.

Shpifjet dhe fyerjet përpos të paditurit të parë i ka përhapur gojarisht edhe V. B-e paditura e dytë, tek shumë njerëz duke i bërë këto thashetheme publike të paktën gjysmën e Gjilanit, dhe duke i shkaktuar paditëses plotësisht reputacion në familje, faqesidhe shoqëri ku shpifjet dhe fyerjet janë transmetuar në familje tek prindi i paditëses, familja e gjërë , miqtë, faqefisi, DKA duke i vështirsuar paditëses të ketë një jetë normale brenda rrethit social..

Më tej ka deklaruar se dëshmitarët e njoftuar me rastin dhe të cilët i kanë lexuar ankesat janë:

- Sh. K.-H. nga Gjilani, ish-U.D.-dhe anëtarët e komisionit
- S. F, M. H, N. Sh që të gjithë nga Gjilani dhe R. B nga, po ashtu ka deklaruar se nga të cekurat më lartë i është cënuar rëndë reputacioni, morali dhe i janë shkaktuar dhimbje shpirtërore nga të padituri gjatë nëntë viteve dëm ky emocional dhe material i cili duhet të kompenzohet për shkak se ajo asnjher nuk arriti të punësohet në këtë mënyrë as nuk ka përfutue materialisht e as me përvojë pune e cila kërkohet si kriter kryesor në çdo konkurs.

Andaj në bazë të cekurave më lartë ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e saj dhe të obligohen të paditurit që t'ia kompenzojnë në emër të cenimit të dinjitetit shumë në vlerë prej 4,000,000 (katër milion) €, në emër të dhimbjeve shpirtërore, cenim të autoritetit dhe të nderit shumë në vlerë prej 4,000,000 (katër milion) € dhe në emër të shpifjes dhe fyerjes shumë në vlerë prej 2,000,000 (dy milion) €.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjegje në padi, me të cilit gjykata i ka bashkëngjitur padin dhe provat në padi dhe i ka njoftuar të paditurit për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për

pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqesin përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes .

I padituri B. S, në përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditëses duke i konsideruar ato si të pavërtetua dhe “të trilluara”, për arsye se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën dëshmon se i padituri e ka fyer, andaj i ka propozuar gjykatës që t'a refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

E paditura V. B R. në përgjigje në padi e ka kontestuar dhe kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se pretendimet e së njëjtës nuk çëndrojnë, e paditura nuk e ka mohuar faktin se është takuar ndonjëherë me paditësen por i ka mohuar thënjet në padi që kanë të bëjnë me fyerjet apo dëmtim të imazhit të paditëses, e prandaj nga këto arsye ka kërkuar që padia të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka caktuar seancën përgatitore me dt.09.12.2020, ku kanë prezentuar paditësja - personalisht, përfaqësuesi i të paditurit Bardhyl Sylja, av.Bardhosh Dalipi dhe përfaqësuesi i të paditurës V. R. B, av.Flakron Abdullahu nga Gjilani.

Në seancën përgatitore, paditësja ka deklaruar se rasti ka ndodhur me 16.03.2018 rreth orës 13:30, ku e njejta kishte shkuar për të kërkuar në D. të A se mos ka ndonjë vend të lirë të punës ose për të zëvendësuar ndonjë prej mësidhënësëve në kabinet të punës të Drejtorisë, ku paditësja pretendon se B. S, ka filluar t'a fyej me fjalë fyerëse dhe ka mbetur prapa thënjeve në përshkrimin e padisë, kurse sa i përket të paditurës V. R. B, tek e njejta paditësja pretendon se ka shkuar të konsultohet për një vend pune të lirë për aplikim dhe e njejta ka pasur sjellje të mira me mua dhe ajo i kishte premtuar se do ta njoftoj paditësen nëse ka zëvendësime, ku në atë moment ka ndërhyrë i padituri B. S i cili i ka thënë të paditurës V. B. R, „*se paditësja nuk ka të kaluar të mirë*”, dhe këto fjalë e paditura V. B. R i ka thënë në biseda të përditshme me kolegët e saj, andaj nga këto rrethana paditësja ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe e njejta i ka propozuar gjykatës që si dëshmitarë të dëgjohen: Sh. K. Haziri, S. F, M. H, N. Sh dhe R. B dhe ka kërkuar zgjerimin e kërkesëpadisë në kuptimin subjektiv, ku ka kërkuar që si e paditur të jetë D. M (bahskëshortja e të paditurit të parë B. S) dhe motra e saj N. M të dyja nga Gjilani.

Përfaqësuesi i të paditurit, parë av.Bardhosh Dalipi, në seancën përgatitore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe thënjeve në të, ndërsa ka shtuar faktin se paditësja pretendon se shpifjet dhe fyerjet ndaj të njëjtës i ka bërë në vitin 2016 fillimisht dhe më vonë me dt.16.03.2018, prandaj lidhur me këtë fakt përfaqësuesi i të paditurit ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet me arsyetimin se afati subjektiv për paraqitjen e padisë ka qenë 3 muaj, ndërsa afati objektiv është 1 vit, gjithashtu i njejti e ka kundërshtuar propozimin për dëgjimin e dëshmitarëve të lartëcekur me arsyetimin se të njëjtit nuk mund të sqarojnë asgjë në lidhje me pretendimet e paditëses, po ashtu përfaqësuesi i të paditurit i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 422.50 €.

Përfaqësuesi i të paditurës së dytë, av. Flakron Abdullahu, në seancën përgatitore ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë duke mbetur pranë përgjigjjes në padi, me faktin se paditësja nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të vërtetoheshin thënjet në padi, po ashtu përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se shpifjet dhe fyerjet për të u konsideruar të tilla duhet t'i drejtohen personit duke i publikuar të njejtat apo këto shpifje apo fyerje duhet të publikohen në media. Më tutje i njejtë ka theksuar se shpifja sipas pretendimeve të paditësës ka ndodhur me datën 02.03.2016, ndërsa sipas Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, kërkesa për kompensim të dëmit është parashkruar, andaj nga këto të pretendime përfaqësuesi i të paditurës ka kërkuar nga gjykata që padinë t'a refuzojë si të pabazuar në ligj e po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 452.20 €.

Gjykata pasi ka vlerësuar dhe analizuar thëniet e palëve ndërgjyqëse gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësës është e pabazuar në ligj për faktin se ka arritur afatin e parashkrimit.

Gjykata deri te një konstatim i tillë ka ardhur duke u bazuar në deklaratat e të paditurëve të cilët janë thirrur në institutin e parashkrimit dhe duke u bazuar në nenin 17 par.1 të Ligjit Civil nr.. 02/L-65 Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, nën ky i cili parasheh se *“Afati për paraqitjen e një kërkesë për kompensim në bazë të këtij Ligji është tre (3) muaj, nga dita kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar është vënë në dijeni ose duhet të jetë vënë në dijeni për shprehjen e faktit të pavërtetë dhe identitetin e autorit, dhe në asnjë rast nuk duhet të kalojë një (1) vit, nga dita kur shprehja është bërë publike”*, andaj në rastin konkret sipas padisë dhe deklaratës së dhënë në seancën përgatitore, paditësja ka theksuar se shpifja ka ndodhur me dt.16.03.2018, pra nga kjo ditë është vënë në dijeni për fyerjet dhe shpifjet e pretenduara nga ana e saj mirëpo padinë për realizimin e së drejtës, në këtë gjykatë e ka paraqitur me dt.13.06.2019 pra jashtë afatit të paraparë ligjor (një vit e tre muaj) po ashtu vlen të ceket se gjykata për parashkrimin e kërkesës së palëve nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, por vetëm në bazë të thirrjes së palëve apo palës në parashkrim si në rastin konkret ku përfaqësuesit e të paditurëve janë thirrur në institutin e parashkrimit në seancën e mbajtur me datë 09.12.2020.

Gjithashtu gjykata duke u bazuar në parimin e ekonomizimit të procedurës ku është obligim i gjykatës, por edhe i palëve që procesi të zhvillohet në mënyrë efikase dhe me shpenzime sa më të vogla që është e mundur, e në rastin konkret pasi që gjykata gjeti se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës ku shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit në procedurë gjyqësore, vendosi që propozimet për dëgjimin e dëshmitarëve dhe propozimin për zgjerimin e kërkesëpadisë në aspektin subjektiv.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 452.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që e paditësja në rastin konkret ka humbur procesin

gjyqësor dhe për këtë arsye vendosi që të paditurëve t'ua paguaj për një saeancë gjyqësore shumë prej 422.50 € e në shumë të përgjithshme për dy të autorizuarit 845.00 €, duke u bazuar në TAK- në.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.526/19, Me datë 09.12.2020**

Gjyqtarja
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.